

KOMITETI DREJTUES

Tiranë, 20 mars 2023

Nr. 17 Prot.

Vendim Nr.2 i KD-së

Kryesia e FSHB-së në mbledhjen e sajë më datë 17 mars 2023, drejtuar nga Presidenti i FSHB-së, Z. Avni Ponari dhe prezencë të anëtarëve, Znj. Edera Alibegaj, Znj. Migena Plasa dhe Z. Dritan Mema diskutuan mbi rendin e ditës si vijon:

1. Ndarja e Fondit Grant transfertë akorduar nga MAS për vitin 2023;
2. Trajnerët e ekipeve kombëtare të moshave U20/18/16 Djem dhe U18/16 Vajza 2023;
3. Organizimi i fazës Final Four U18 Vajza dhe U18 Djem;
4. Të ndryshme.

Për sa më sipër KD-ja vendosi:

1. Miratimin e ndarjes së Fondit Grant të akorduar nga MAS për vitin 2023 sipas parashikimit të shpenzimeve lidhur me organizimet kombëtare dhe ndërkombëtare;
2. Kryesia pas diskutimeve rreth aplikimeve të mbërritura të trajnerëve të interesuar për drejtimin e ekipeve kombëtare të moshave gjatë vitit 2023, urdhëroi administratën e FSHB-së për organizimin më datë 5 prill të një takimi të hapur për diskutim nën drejtimin e Presidentit dhe me të ftuar trajnerët që kanë aplikuar dhe të tjerë të interesuar;
3. Kampionatet kombëtare U18 djem dhe vajza 2022-23.
 - 3.1 Organizimin e Final Four U18 vajza në ambientet e pallatit të sportit "Qazim Dervishi", Shkodër. Datat dhe oraret do të publikohen nga administrata;
 - 3.2 Organizimin e Final Four U18 djem në ambientet e pallatit të sportit "Dhimitraq Goga", Durrës. Datat dhe oraret do të publikohen nga administrata;
4. Të Ndryshme.
 - 4.1 Realizimin e aktiviteteve lidhur me projektet e FIBA-s për zhvillimin e të rinjve në basketboll dhe promovimin e basketbollit tek vajzat e vogla duke përmbyllur në muajin qershor programin për edicionin 2022-23.